



Fier, më 16.06.2026

## DRAF-RAPORT

### **“Për miratimin në parim të vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier”**

Mbetjet inerte, siç përkufizohen në ligjin nr. 10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, janë mbetjet të cilat nuk transformohen kimikisht, fizikisht, apo biologjikisht dhe nuk ndërveprojnë kimikisht me lëndë të tjera. Këtu përfshihen ndër të tjera edhe dherat e gërmimeve të ndërtimit si dhe materialet nga ndërtimi dhe shembja. Duke përjashtuar rastin kur këto materiale mund të ripërdoren për ndërtim, destinacioni final i tyre është depozitimi në Landfill (vend grumbullim mbetjesh). Në kushtet kur Landfill ekzistues i mbetjeve është në kapacitetin e tij maksimal, deri në ndërtimin e Landfill të reja të dedikuara për këto lloje mbetjesh, Bashkitë në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 448 dt. 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit 10 431 dt. 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Vkm 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, i ndryshuar, VKM nr. 509 dt. 06.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Qendër Bashkia Fier Qarku Fier”, VKM 510 dt. 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial”, duhet të identifikojnë pasuritë që do të shërbejnë si vend-depozitime të përkohshme të mbetjeve inerte.

Në zbatim të këtyre detyrimeve ligjore nga ana e ekzekutivit të Bashkisë Fier janë kryer verifikimet e nevojshme për identifikimin e pasurive të cilat mund të shërbejnë si vend-depozitime të përkohshme të depozitimit të mbetjeve inerte. Konkretisht nga Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave Bashkia Fier me shkresën Nr. 7162/1 prot. dt. 16.06.2026 janë propozuar: -Sipërfaqja prej 20 000 m<sup>2</sup> pjesë e pasurisë nr. 107/1, zk. 1874 e llojit “tokë pa fruit” ndodhur në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, pronë e certifikuar në emër të Bashkisë Fier; -Pasuria nr. 204 me sipërfaqje totale 5 826 m<sup>2</sup>, pjesë e pronës me nr. Inventari 999, zk. 1557 e llojit “tokë bujqësore jo produktive fshati Drizë Komuna Qendër”, sipas VKM nr. 509 dt. 06.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Qendër Bashkia Fier Qarku Fier”.

Gjithashtu pranë Bashkisë Fier është paraqitur kërkesa me lëndë “Shprehje interesi pa shpërblim” e protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 7759 prot. dt. 17.06.2026 e shoqërisë “Albania Energy &

Oil Trade” (AEOT) sh.p.k. me Nuis L32604402E, subjekt i cili operon në fushën e prodhimit të produkteve me bazë qeramike, të destinuara për përdorim në sektorin e ndërtimit, si dhe deklarata noteriale nr. 2029 rep. nr. 1212 kol. dt. 17.06.2026 të kësaj shoqërie, me anë të të cilës shoqëria “AEOT” ka shprehur vullnetin dhe gadishmërinë për t’vënë në dispozicion të subjektit Bashkia Fier pasuritë e paluajtshme, të cilat i ka në pronësi dhe mund të përdoren përkohësisht si venddepozitim mbetjesh inerte dhe konkretisht:

Ekzekutivi i Bashkisë Fier në përfundim të vlerësimit të pasurive të sipërcituara, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 801-825 të K.Civil, ligjin nr. 10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 448 dt. 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit 10 431 dt. 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, Vkm 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, i ndryshuar, VKM nr. 509 dt. 06.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Qendër Bashkia Fier Qarku Fier”, VKM Nr. 363 dt. 01.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Topojë Bashkia Fier Qarku Fier”, VKM 510 dt. 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitet e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial”, VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” propozon:

### **Miratimin në parim të vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier në pasuritë si më poshtë:**

- Sipërfaqja prej 20 000 m<sup>2</sup> pjesë e pasurisë nr. 107/1, zk. 1874 e llojit “tokë pa frut” ndodhur në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, pronë e certifikuar në emër të Bashkisë Fier;
- Pasuria nr. 204 me sipërfaqje totale 5 826 m<sup>2</sup>, pjesë e pronës me nr. Inventari 999, zk. 1557 e llojit “tokë bujqësore jo produktive fshati Drizë Komuna Qendër”, sipas VKM nr. 509 dt. 06.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Qendër Bashkia Fier Qarku Fier”;
- Pasuria nr. 39/56 zk. 3981 me sipërfaqje 15 000 m<sup>2</sup> e llojit “arë” ndodhur në Sheq i Madh, Fier, në pronësi të shoqërisë “Albania Energy & Oil Trade” (AEOT) sh.p.k.

### **Ju faleminderit!**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. 7162/2 prot

Fier, më. 16 06.2026

**NJOFTIM PER DEGJESE PUBLIKE**

**BANOREVE TE KOMUNITETIT TE FIERIT DHE GJITHE PALEVE TE**

**INTERESUARA**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, në nenin 9, pika 1.3, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 18 , në rregulloren e Këshillit Bashkiak për konsultimet publike

Ju njoftojmë se do të zhvillohen dëgjesa publike , në kuadër të:

***Miratimit në parim të pikave të depozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier.***

Ftojme të gjithë grupet e interesit si qytetarë, (pjesëmarrjen e përfaqësuesve të kompanive të ndërtimit, ekspertëve mjedisorë, drejtuesve të komuniteteve ku janë propozuar këto pika), si dhe organizatave të shoqërisë civile që mbrojnë interesat publike dhe mjedisore të qytetit tonë. Kontributi juaj është kyç për të garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Nr	Takimi	Dita e takimit	Data e takimit	Vendi	Ora
1	Topojë	E Enjte	16.07.2026	Qënder	10:00
1	Qëndër	E Premte	17.07.2026	Qënder	10:00

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve të cilat do te shërbejnë për orientimin në hartimin e materialit për : « ***Përcaktimin e vendndodhjeve specifike të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier.*** »

.Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të emailit :

[Neritan.Bocova@bashkiafier.gov.al](mailto: Neritan.Bocova@bashkiafier.gov.al) Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Këto dëgjesa do te zhvillohen në bashkepunim me Bashkinë dhe , Antarë / përfaqësues të Këshillit Bashkiak Fier,

Jeni të lutur të merrni pjesë pasi pjesmarrja juaj është shumë e rëndësishme.

**KRYETARI**  
**Armando SUBASHI**

